



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 maj 2014

Numri i lëndës: 2014-04

Tomë Krasniqi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 maj 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 3 shkurt 2014.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës ashtu siç janë parashtruar nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim:
3. Ankuesi pohon se përmes një vendimi të datës 3 maj 1998, lëshuar nga *"Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor në ish Federatën e Jugosllavisë, filiala në Prishtinë"*, atij ju ishte njohur e drejta për shfrytëzimin e pensionit. Sidoqoftë, nga data 1 dhjetor 1998 e deri më sot, ai nuk ka marrë ndonjë pagesë.
4. Është paraqitur se ankuesi gëzon të drejtën për pension sipas dispozitave të Ligjit mbi Sigurimin Pensional e Invalidor të vitit 1983, e cila thuhet se është *"në përputhje me Rregulloren e UNMIK 1999/24"*. Ankuesi pohon se UNMIK-ut e më pas autoritetet e Kosovës janë të obliguara t'ja ofrojnë pagesën e pensioneve.
5. Më 4 maj 2007, ankuesi ka ushtruar padi kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
6. Më 16 shtator 2009, ankuesi ka dërguar një letër drejtuar shefit të misionit të EULEX-it në Kosovë, e cila ishte pranuar në të njëjtën datë nga njësia e gjykatësve të EULEX-it.
7. Më 8 dhjetor 2009, një gjykatës i EULEX-it nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë e ka njoftuar ankuesin se pasi që lënda e tij ishte një kontest në lidhje me *"të drejtat e tij për pension dhe jo një kontest prone, në bazë të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kjo lëndë nuk bie në juridiksionin e EULEX-it"*. Prandaj ankuesi është njoftuar se EULEX-i nuk mund të marrë përsipër këtë lëndë.
8. Më 17 janar 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur që Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale *"i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike civile, bazuar në faktet se i padituri nuk është konsideruar se është pasardhës ligjor i ish 'Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor' që ka ekzistuar deri në vitin 1999"*.
9. Më 17 janar 2013, ankuesi është ankuar në Gjykatën e Apelit të Prishtinës. Më 7 tetor 2013, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë ankesën si të pabazuar, duke e vërtetuar arsyetimin e Gjykatës Themelore.

III. ANKESAT

10. Ankuesi në thelb pohon se neni 1 i protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjithashtu përfshin të drejtat e pensioneve dhe se pezullimi i pagesave përbën shkelje të së drejtës së tij për gëzim të qetë të pronës së tij. Më tej, ankuesi thirret në nenin

3 të KEDNj-së si dhe nenin 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Përveç kësaj, ankuesi konsideron se gjykatat e Kosovës nuk kanë vendosur rreth çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur të drejtat e tij për gjykim brenda afatit të arsyeshëm sipas nenit 6(1) të KEDNj-së.

IV. LIGJI

11. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
13. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
14. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë para gjykatave të Kosovës. Në parim dhe duke iu nënshtruar cilësimit të përmendura më poshtë, Paneli nuk ka kompetencë që të shqyrtoj as aspektet administrative e as aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Ato janë kompetencë që i takojnë vetëm gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka konstatuar se edhe nëse gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera *Maxhuni kundër EULEX-it*, nr. 2013-24, par. 12; 7 prill 2014, par. *Halili kundër EULEX-it*, nr. 2012-08, 15 janar 2013, par. 21; *Pajaziti kundër EULEX-it*, nr. 2012-05, 4 tetor 2012 par. 9-10; *Dobruna kundër EULEX-it*, nr. 2012-03, 4 tetor 2012, par. 12).
15. Prandaj, në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj vendimet e gjykatësve të EULEX-it si të tilla. Sidoqoftë, Paneli tashmë ka konstatuar se nuk mund të përjashtohet që në rrethana të caktuara kompetencat e Panelit të përfshijnë vendimet dhe aktet e autoriteteve të prokurorisë në hetimet penale edhe nëse ato ju kanë nënshtruar ndonjë shqyrtimi

gjyqësor pasues. Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe kur akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk janë trajtuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente (shih Z kundër EULEX-it, nr. 2012-06, 10 prill 2013 në par. 34). I njëjti arsyetim mund të vlej për ndonjë ankesë që ka të bëjë me veprimet dhe vendimet e autoriteteve gjyqësore dhe si të tilla ku akuzat e besueshme për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen gjykatësve të EULEX-it nuk janë trajtuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente në procedurën e ankimit.

16. Në këtë aspekt, Paneli i drejtohet memorandumit shpjegues të datës 15 shtator 2009 të konceptit llogaridhënës të EULEX-it në Kosovë. Kjo e bën të qartë se Paneli nuk përjashtohet nga ndërmarrja e vlerësimit të veprimeve gjyqësore siç janë: *"[të gjitha] çështjet me të cilat janë marrë gjykatat e rregullta në Kosovë duhet të trajtohen [...]. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjyqësori në vete është i liruar tërësisht prej shqyrtimit nga Paneli. Në të njëjtën mënyrë ashtu si veprimet individuale nga një gjykatës mund të trajtohen veç e veç në rast se veprimi i gjykatësit përbën shtrembërim e zhvillimit të drejtësisë, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të natyrës së ngjashme apo shkeljet e të drejtave procedurale të njeriut, veçanërisht të drejtën për gjykim të drejtë. Paneli do të respektojë në çdo kohë pavarësinë e gjyqësorit."*
17. Duke u kthyer në rrethanat e çështjes në fjalë, Paneli konstaton se ankuesi ankohet kundër vendimeve të gjykatave të Kosovës si dhe kundër qëndrimit të marrë nga gjykatësi i EULEX-it se lënda e ankuesit nuk kanë hyrë në kuadër të juridiksionit të EULEX-it.
18. Në lidhje me të parën, Paneli konsideron se nuk është treguar e as argumentuar se gjykatësit e EULEX-it kanë qenë të përfshirë në ndonjë cilësi në marrjen e këtyre vendimeve (shih *Mustafa kundër EULEX-it*, 2011-03, 8 prill 2011, në par. 22).
19. Në lidhje me të fundit, Paneli nuk sheh ndonjë tregues se gjykatësi i EULEX-it ka shkelur të drejtat e njeriut të ankuesit kur iu ka përgjigjur ankesës së tij (shih par. 7 më lartë).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese